



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA SHKODËR

Nr. 11478 Prot

Shkodër, më 17. 8. 2023



I.B.C - TELECOM

Nr. 33 Prot

Shkodër, më 17. 08. 2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje, lidhet sot me datë _____. _____. 2023 ndërmjet:

Bashkisë Shkodër, përfaqësuar nga **z.Benet BECI** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr.G50125189U, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rruga "13 dhjetori", Shkodër.

dhe

I.B.C-TELECOM shpk, regjistruar pranë Regjistrat Tregtarë me datë 01.06.2010. me NIPT L06801002A përfaqësuar nga z.Gjergj Ejlli në cilësinë e administratorit të shoqërisë, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nr.rep.2499, nr.kol.9517 dt.07.09.2019 nga z.Eder Ndoci mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr.I80520132N, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë: Rruga: "Marin Bicikemi", Përballë Katedrales Nr. 9 Shkodër.

Në kuadër të bashkëpunimit për përmirësimin e shërbimit të internetit në qytetin e Shkodrës dhe zonave turistike përreth tij, IBC TELECOM bie dakort të ofrojë shërbimin "Free Wi-Fi" në disa zona të caktuara turistike të territorit nën juridiksionin e bashkisë Shkodër.

Ky shërbim jepet me qëllim që t'i ofrohet qytetarve, turistëve dhe çdo kujt tjetër që ka nevojë për shërbimin e internetit pa pagesë, në zonat ku do të mbulohet ky shërbim.

Neni 1 Baza ligjore

Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me :

Ligjin nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ i ndryshuar
Ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale” i ndryshuar;
Ligjin nr.7850, datë 27.09.1994 “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Neni 2 Objekti

2.1 Objekti i marrëveshjes është ofrimi i shërbimit “Free Wi-Fi” (internet falas) në disa zona të caktuara turistike të territorit nën juridiksionin e bashkisë Shkodër, sipas plan-vendndosjes bashkëngjitur kësaj marrëveshje.

Neni 3

Qëllimi

3.1 Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje bashkëpunimi është ofrimi i shërbimit të internetit pa pagesë.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e I.B.C - TELECOM

I.B.C - TELECOM merr përsipër:

- 4.1 Ofrimin i shërbimit “Free Wi-Fi” (internet falas) në zonat e mbulimit sipas plan-vendndosjes bashkëngjitur kësaj marrëveshje bashkëpunimi;
- 4.2 Instalimin e strukturave - paisjeve “Wi-Fi” me shpenzimet e veta sipas plan-vendndosjes bashkëngjitur, me qëllim ofrimin e shërbimit të internetit, pa pagesë;
- 4.3 Të markojë me logon e I.B.C – TELECOM dhe Bashkia Shkodër materialet promovuese për sinjalizimin dhe promovimin e strukturave-paisjeve “Free-Wi-Fi” sipas formatit të miratuar nga Bashkia Shkodër;
- 4.4 Të gjitha shpenzimet për blerjen e strukturave - pajisjeve, instalimin, dhe mirëmbajtjen e tyre deri në përfundim të marrëveshjes;
- 4.5 Të kujdeset që strukturat-paisjet të jenë funksionale gjatë gjithë kohës dhe të kryejë sipas rastit mirëmbajtjen e tyre;
- 4.6 Riparimin e dëmtimeve të ardhura si rezultat i kushteve atmosferike apo të lloj natyre tjetër.
- 4.7 Ngarkohet me përgjegjësi I.B.C-Telekom për cdo lloj dëmtimi të shkaktuar gjatë montimit të strukturave-paisjeve “Free-Wi-Fi”;

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Shkodër

Bashkia merr përsipër:

- 5.1 Të vërë në dispozicion të IBC - TELECOM vendndodhjen ku do të vendosen strukturat-paisjet "Free-Wi-Fi" saktësisht sheshi para Bashkisë Shkodër, sheshi para Shatërvanit Shkodër, sheshi nanë Tereza, Pedonalia Gjuhadol, Rruga Kolë Idromeno, Rruga "28 Nëntori", Katedralia - Shkodër, sheshi Demokracia, Sheshi Stadiumi "Loro Boriçi" Shkodër, Shëtitore Molo, Shëtitore Shirokë, Pedonale Velipojë, Ujëvara Theth, Kisha Theth;
- 5.2 Struktura përgjegjëse pranë bashkisë Shkodër vë në dispozicion plan-vendndosjet sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje;
- 5.3 Bashkia Shkodër merr përsipër të krijojë kushtet e favorshme për lidhjen e energjisë elektrike pa dëmtuar rrjetin;

Neni 6
Kohëzgjatja

6.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi është e vlefshme për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë rinovimi sipas kërkesës.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Palët angazhohen për zgjidhjen me mirëkuptim të çdo mosmarrëveshje që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj akt-marrëveshje, në rast të kundërt i lind e drejta për t'ju drejtuar Gjykatës kompetente.

Neni 8
Hyrja në fuqi

8.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 9
Njoftimet

9.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë marrëveshje bëhen me shkrim, duke i'u dorëzuar personalisht personave të kontaktit si më poshtë vijon:

a) Për I.B.C - TELECOM

Adresa: Rruga "Marin Bicikemi", Përballë Katedrales Nr 9 Shkodër, Shqipëri
E-mail: zyraturidike@ibc.al; Tel.: +35590)22600 700 ; Cel : +355692476601

b) Për Bashkinë Shkodër.

Adresa: Rruga 13 Dhjetori, Shkodër, Shqipëri
E-mail: infobashkiashkodër.gov.al; Tel: +35522400150

Neni 10
Dispozita të fundit

10.1 Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj marrëveshje.


10.2 Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj marrëveshje bëhet vetëm në formë të shkruar.

10.3 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë, të cilat pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.

Për IBC – TELECOM
Përfaqësuesi me prokurë

Eder Ndoci


Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë



Për bashkinë Shkodër
Kryetar

Benet BECI

Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë



Konceptoi: H.Rragami M.Fushaxhia A.Shkja (Specialisti)
Pranoi: L.Jaku (Përgjegjës)
Miratoi: B.Mjeda (Drejtor)